



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRI I SHQIPTËRIE PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Mars 2022

3

Ministri i Shtetit
për Rininë dhe Fëmijët



HARTOHET DRAFTI I PARË I STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË 2022-2029

Drafti i parë i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, që synon fuqizimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse, u finalizua pas konsultimit me të rinjtë nga e gjithë Shqipëria në eventin e mbajtur në **Qytezën e Fëmijëve, Korçë**, më datë 19-20 mars 2022. Gjatë këtij event, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe afro **200 gjimnazistë nga e gjithë Shqipëria**, shqyrtuan dhe rishikuan shtyllat e veçanta të Strategjisë siç është **fuqizimi dhe pjesëmarrja rinore, autonomia dhe barazia rinore**, si dhe **mirëqenia sociale**, bazuar në mendimet dhe propozimet e vetë të rinjve. Aspektet tjera të Strategjisë si **novacioni dhe edukimi cilësor, përfshirja sociale, qeverisja dhe administrimi i politikave rinore** ishin gjithashtu pjesë e tematikat e diskutuara përgjatë eventit. Mbi të gjitha gjatë këtij aktiviteti të rinjtë patën mundësi të përfshihen në aktivitete kulturore, sportive, të mësonin më shumë mbi orientimin e karrierës dhe të dëgjonin disa prezantime nga të rinj të talentuar në fushat e teknologjisë së informacionit, artit, sportit, dhe kulinarisë. **Organizimi dhe punimet e këtij aktiviteti u realizuan në partneritet dhe me mbështetjen e UNICEF, World Vision dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO).**



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT ME UNDP-NË PËR FINANCIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE RINORE

Nënshkruhet memorandum i bashkëpunimit mes **Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët** dhe përfaqësueses së zyrës së Programin e **Kombeve të Bashkuara për Zhvillim UNDP në Tiranë**, që do të mundësojë rritjen e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, si dhe menaxhimin e granteve shtetërore për rininë, sipas standardeve të BE-së.

Zbatimi i metodologjisë LOD që do të zbatohet duke nisur nga thirrja e vitit 2022 për financimin e projekt-propozimeve rinore të AKR-së, **do të rrisë transparencën, efektivitetin dhe angazhimin e vetë të rinjve në të gjitha hallkat e këtij procesi.**

Aktivizimi rinor, edukimi joformal, gjithëpërfshirja, inovacioni dhe sipërmarrja e të rinjve, do të marrin hov të veçantë përmes realizimit të këtij memorandum bashkëpunimi.

NIS ZBATIMI I PROJEKTIT "QËNDRO" I MBËSHTETUR NGA AMBASADA ITALIANE NË SHQIPËRI DHE UNICEF

Projekti **"Qëndro"**, i financuar nga Qeveria Italiane dhe implementuar nga UNICEF, mbështet prioritetet e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes mundësisë të një qasjeje novatore dhe sistematike fokusuar në: **përmirësimin e praktikave të shkollës për të rritur cilësinë e arsimit, si dhe rritjen e aftësive për jetën dhe punësimin për të rinjtë, hartimin e programeve të orientimit në karrierë, ngritjen e qendrave teknologjike në 25 shkolla dhe trajnimin e mësuesve për aftësi digjitale që do të ndikojë në përmirësimin e fushës së digjitalizimit.** Po ashtu dhe **aftësimin për jetën dhe punësimin e të rinjve**, përmes zhvillimit të një kurrikule për trajnimin mbi aftësitë e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe mbështetjes së kërkimit të punës. Si partner kyç i këtij programi që synon të përfshijë të rinjtë, mësuesit, shkollat dhe komunitetin përreth, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, mori pjesë në ceremoninë hapëse të këtij projekti, më datë 2 mars.



KONSOLIDOHET PROGRAMI I DELEGATËVE RINORË TË SHQIPËRISË NË KOMBET E BASHKUARA.

Me qëllim konsolidimin e njërit prej modeleve më të suksesshme të aktivizimit të të rinjve në mënyrë cilësore, atij të Programit të Delegatëve Rinorë të Shqipërisë në Kombet e Bashkuara (OKB), **u nënshkrua memorandum i bashkëpunimit mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë (UNAA).** Përmes mbështetjes së Ministrit ndaj programit, synohet rritja e rolit dhe përfshirjes së delegateve rinorë në forumet ndërkombëtare të OKB-së dhe në agjendën kombëtare të të rinjve në Shqipëri.

AKR DHE KKR NËNSHKRUAJNË MEMORANDUMIN E BASHKËPUNIMIT PËR FUQIZIMIN RINOR NË SHQIPËRI

Në kuadër të titullit **"Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022"**, AKR, nënshkroi në datë 02 Mars 2022 Memorandumin e Bashkëpunimit me Kongresin Rinor Kombëtar (KRK). Ky bashkëpunim do të ketë në fokus **fuqizimin e të rinjve** dhe angazhimin e tyre përgjatë vitit 2022, duke bashkërenduar iniciativat, përpjekjet dhe eventet e dy institucioneve. Gjatë nënshkrimit u theksua se bashkëpunimi dhe fuqizimi i të rinjve do të mbeten fokusi i partneritetit të ardhshëm mes AKR dhe KRK. Memorandume të tilla bashkëpunimi me organizatat rinore/ për të rinjtë, gjejnë mbështetjen e plotë nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, si një mjet efektiv për fuqizimin e rolit dhe ndërtimin e iniciativave për të rinjtë në nivel lokal dhe kombëtar.



@bora_muzhaqi



@MuzhaqiBora



@bora_muzhaqi



@boramuzhaqi